

JU PREZANTOJMË KRIJUESIT TANË LETRAR NË MËRGATË

SAPO DOLI NGA SHTYPI ROMANI "MISIONI I KRIMINELIT" I GËZIM AJGERAJT

Ky krijues që jeton dhe vepron në Zvicër deri më tash, pos këtij libri që i kushtohet krimeve serbe në Kosovë gjatë luftës së fundit, ka botuar edhe një sërë veprash në poezi e prozë ndërsa nga janari i vitit 2004, editon revistën:

"Metafora" (Editorial i poetit) që del në çdo tre muaj si dhe është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, në Prishtinë ndërsa nga 23 marsi 2002 është edhe anëtarë i Lidhjes së Shkrimtarëve të Zvicrës

Cyrih, 17 shtator

Në radhën e poetëve tejet aktiv, si në krijimtari ashtu jetën kulturore të bashkatdhetarëve në Zvicër, pa dyshim hynë edhe poeti Gëzim Ajgeraj. Ky krijues i frytshëm, deri më tash ka bërë emër në fushën e krijimtarisë sonë artistike me një sërë veprash si në poezi ashtu edhe në prozë. Pas disa publikimeve artistike, sapo i doli nga shtypi romani më i ri "Misioni i kriminelit", botuar në kuadër të publikimeve letrare "Metafora" në Prizren. Nga biseda e shkurtë që sapo kemi zhvilluar me te, mësuam se ky roman bënë fjalë për krimet dhe mizoritë e fundit të kriminelëve serbë në rrethinë e Prizrenit e më gjerë në Kosovë. Lektor i këtij libri është Ilam Berisha, prof., ndërsa kopertinat janë punuar nga Artan e Ardian Ajgeraj. Thënë në mënyrë telegrafike për biografinë e tij: Gëzim AJGERAJ, u lind më 6 gusht 1967 në Malësinë e Vërrinit ndërsa shkollimin e lartë e mbaroi në Prizren dhe HTL (6 semestral) për elektronik në Zvicër. Pra shkollimin e mbaroi në Malësi dhe në Prizren për të vazhduar më vonë edhe në Zvicër. Do theksuar se Gëzim Ajgeraj është një poet i arratisur larg atdheut, i cili përreth dy dekada, apo me mirë të themi gati gjysmën e jetës së tij e kaloi jashtë vendit të vet këtu në Zvicër, kur në vitin 1988 u arratis nga atdheu i robëruar dhe mori botën në sy. Ai edhe në krijimtarinë e tij flet me nostalgji për vitet e rinisë, vite këto që u rrit e i kaloi në qytetin e bukur, në qytetin e lashtësive historike, në qytetin e Abdyll Frashërit e Ymer Prizrenit, buzë rrjedhës së çiltër të Lumëbardhit. Ishin vitet e rënda, vitet e lëvizjeve të mëdha në Kosovë kur Gëzimi u largua nga vendlindja, duke qenë i pranishëm me tërë qenien pranë dheut të lindjes.



Poeti dhe shkrimtari Gëzim Ajgeraj

Gjashtë vjet veprimi në ilegalitetit, moralisht u kalit, tradicionalisht i frymëzuar nga një ideal i lartë drejt përpjekjeve për çlirimin e atdheut.

I MËRGUARI

Kafkës së tij digjet mendimi

Zjarri i shekullit bëhet hi

Fjala i mbaron harrimit

Një copë atdhe përvëlon në gj.

Një mal urimesh përtej shtatë bjes-

hkëve

Në krah të dallëndyshes fluturon

çdo ditë

Nis kah Kosova me të ndër male

Merr këto lule dhe pakëz dritë.

Digjet Kosova digjet mendimi

Lumit të jetës shafraan çdo ditë

Brenda vetvetes e ndrydh zemëri-

min

Djeg kalendaret e ik e ik

(Gëzim Ajgeraj)

Gëzim Ajgerajn, kurdoherë e gjejmë të pranishëm nëpër demonstrata që organizoheshin kundër shtypjes e shfrytëzimit nga ana e okupatorit serb.

Herët filloi krijimtarinë e tij letrare


Mësojmë gjithashtu se krijimtaria letrare e Gëzim Ajgerajt fillet e para i ka që nga klasat e para të fill-ores, ndërsa nga vitet e para të shkollimit të mesëm, duke mos u ndalur deri në përfundimin e luftës më 1999. Ndonëse larg atdheut fizikisht, veprimi i tij, tashmë edhe më i mobilizuar në shërbim të atdheut, kudo që kishte vërrinas e të tjerë shqiptarë nëpër Evropë, Gëzimi qëndronte në ballë të organizimeve për ta ndihmuar luftën edhe moralisht edhe materialisht duke gjetur përkrahje të plotë nga shokët me të cilët bashkëpunonte. Marrë në përgjithësi është e pandashme krijimtaria letrare e tij gjatë gjithë kësaj kohe. Ai që nga viti 1987, filloi të botojë librat e para: Gëzim AJGERAJ, ka botuar këto libra: 1. Klithmë malli, poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1997 2. "Ëndrra për parajsë", poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1998 3. "Qiellit po digjem", poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1998 4. "Flakë në plagë", poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1998 5. "Kënga e babait", poezi për fëmijë, "Apolonia", Prishtinë, 1998. 6. Urti popullorë të Vërrinit I (bashkautorësi), "Apolonia", Prishtinë, 1998 7. Mallëngjimi, poezi, "Rilindja", 2000. 8. Balada e Vërrinit, K.L. "F. S. Noli", Prizren, 2001. 9. "Ruga e lirisë", dramë,

Fragment nga romani "Misioni i kriminelit" "Përtej shtriheshin copa muresh, rrënoja, makineri ushtarake e objekte tjera të djegura deri në themel. Kjo ia shtoi trishtimin dhe frikën se luftën do ta humbnin. Megjithatë ai nuk jepej para përcjellësve të tij. Pamjet e vrazhda të këtyre goditjeve, sikur ia kërcënonin realizimin e misionit. I pari i tij e priste krenar atje lart në Beograd. Hë pra, ai duhej ta kryente misionin. Do të bëjë cmos. Do t'i shfarosë shqiptarët dhe do ta shkulë qytetin. Lavdia do t'i ngrihet atje në Kalamegdan. Misioni i lartë në lavdin e tij. Gjatë atyre casteve, iu kujtuan fjalët e të parit të tij që ia paskësh thënë përpara nisjes tek po ia jepte dosjet në dorë: "Ti do të jesh lavdia dhe krenaria e Serbisë". Qe rraçetur derisa i kishte marrë në dorë ato dosje... Ky ankth e kishte dërmuar. Aq më tepër fjalë e gruas së tij, Svetlanës, e cila përpara nisjes i paskësh thënë: Kosova ua ka ngrënë kokat e sundimtarëve gjithmonë, - të lutem mos shkol Ky zë i gruas së tij i kishte mbetur në vesh. U zgjua trembshëm nga ulësja ku po dremiste një sy gjumë nga trokitja në derë e kamerierit që i solli shishen e shlivovicës."

"Meshari" Prishtinë, 2001. 10. Rruga e lirisë (intervistë) me Zafir Berishën, botoi Asociacioni i veteranëve të ish UÇK-së - Prizren, 2002. 11. Atdheu në trastë-cikli me poezi, e botoi revista letrare "Jeta e re" nr. 4, korrik-gusht 2002, viti LIV, Prishtinë. 12. Pëllumbat e lirisë, Novelë për fëmijë, Edicioni i revistës; Fidani, Prizren, 2004. 13. Ditët e bardha, Novelë për fëmijë, Edicioni i revistës; Fidani, Prizren, 2004. 14. Atdheu i copëtuar-cikël me poezi, në librin: Piko molla gjak (Lirikë me motive arvanitase), botoi MKRSCJR-Departamenti i Çështjeve Jorezidente, Prishtinë, 2004. 15. Cikël me poezi; "Udhë e zjarmi", në librin: Muzat i bien lirisë, Edicioni i revistës; Fidani, Prizren, 2005. 16. "Lulëkuqet e Vërrinit", poezi, botoi Shtëpia botuese "Metafora", Zvicër, 2005. Ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me të gjitha gazetatat dhe revistat e kohës, si:

"Rilindja", Zvicër - Prishtinë, "Bujku", - Prishtinë, "Zëri i Kosovës", Zvicër - Prishtinë, "Bota sot", - Zvicër, "Koha ditore", - Prishtinë, "Epoka e re", - Prishtinë, "Zëri", - Prishtinë, "Fakti", - Shkup, "Ars" - Tiranë, "Penashqiptare", - Prishtinë, "Pioneri" - Prishtinë, "Zogu i mëngjesit", - Prishtinë, etj. Nga janari i vitit 2004, editon revistën: Metafora poetike (Editorial i poetit) që del çdo tre muaj. Është anëtarë i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, në Prishtinë. Nga 23 marsi 2002 është anëtarë i lidhjes së shkrimtarëve të Zvicrës (SSV). Jeton dhe krijon në Zvicër, në Grabs SG. Nga janari i vitit 2004, editon revistën: "Metafora" (Editorial i poetit) që del në çdo tre muaj. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, në Prishtinë. Nga 23 marsi 2002 është anëtarë i Lidhjes së Shkrimtarëve të Zvicrës

Rexhep Rifati



Kopertinat e romanit "Misioni i kriminelit"